Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Shaban Tafa	**01.11.2023**	**12.11.2023**	**2023/0845**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.10.2023, OE "TALI SH.P.K."- Gjilan, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0845, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirembajtja dimerore e Rrugeve ne Gjilan" me nr. të prokurimit: "651-23-10479-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates: 390,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Kërkesat ne dosjen e tenderit nuk janë përgatitur ne pajtim me qëllimin dhe kërkesës ligjore te prokurimit publik sepse ne kriteret e Aneksit nr.7 - Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm si dhe tek kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional janë vendosur kërkesa jo relevante duke favorizuar OE te caktuar, me këtë veprim duke ndikuar ne uljen e konkurrencës se lire ne mes te Operatorëve Ekonomik.

Neni 1 të Ligjit Nr.04/L-042, Qëllimi:

Neni 6 të Ligjit Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 të Ligjit Nr.04/L-042, Barazia ne Trajtim/ Jo Diskriminimi

Neni 69 të Ligjit Nr.04/L042, Pika 1

Ne këtë rast Kërkesat e Aneksit Nr.7 - Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm si (me nr rendor sipas Aneksit 7):

Kamion special për pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhja e kripës mbi 10 ton

Arsyetimi për: nr.1 Kamion special për pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës mbi 10 ton, Ky kriter nuk është i arsyeshëm sepse ne rrugët e qytetit nuk është e nevojshëm te kërkohet mbi 10ton.

Duke u bazuar ne vitet e kaluara ne kriteret e Mir. Dimërore asnjëherë nuk janë specifikuar tonazhet e kamionëve te bores. Specifikimi i toneve ne këtë mënyrë dyshohet se favorizon një kompani e caktuar.

Arsyetim për: nr.3 dhe 4 – Traktor mbi 2 tone për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës.

Traktori për pastrimin e trotuarit dhe hedhjen e kripës mbi 2 ton.

Arsyetim për: nr.3 dhe 4 Traktori mbi 2 ton për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës.

Traktor për pastrimin e trotuareve dhe hedhjen e kripës max 2 ton.

Këto kritere janë te panevojshme, pse duhet te jene 2 traktor me tone te caktuar, pasi qe kërkesat për këto dy pajisje janë shume te përafërta mbi ton dhe max 2 ton.

11. Kamion special me pajisje mulqer për kositjen e brezit te rrugëve

Arsyetimi për: nr.11 Ne Mir. Dimërore nuk behet kositja e brezit te rrugëve.

12. Kamion për tërheqjen e ujërave fekale/zhbllokimin e kanalizimeve me peshe bartëse min 9.000kg

Arsyetim për: nr.12 Pajisja me nr 12 – Kamion për tërheqjen e ujërave fekale/zhbllokimin e kanalizimeve me peshe bartëse min 9.000kg – kjo kërkesë është e pa nevojshme ne këtë rast sepse tërheqjen e ujërave fekale/zhbllokimi i kanalizimit ne qytetin e Gjilanit është pune/detyre e ujësjellësit rajonal KRU "Hidromorava" sh.a dhe asnjë person apo subjekt nuk duhet te kryeje asnjë lloj punimi ne sistemin e kanalizimit përveç ndërmarrjeve publike.

Nga ana e AK janë shkelur një more dispozitash ligjore, duke i kufizuar qe te jene te nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Siç shihet ne rrethanat faktike, rezulton se janë bere shkelje te shumta sepse kriteret e përzgjedhjes te vendosura ne këtë aktivitet te prokurimit janë përshtatur sipas OE-ve te caktuar e jo sipas kërkesave ligjore te prokurimit publik.

Andaj kërkojmë nga AK qe te hiqen këto kritere diskriminuese, te cilat ulin konkurrencën duke penguar pjesëmarrjen e OE te cilët kane interes te marrin pjese.

Vërejtje: Kërkesa për ri shqyrtim nga ana jone është bere ne përputhje me afatet kohore (me datën 18.10.2023)

Pezullimi i aktivitetit te prokurimit është bere me 19.10.2023

Me datën 23.10.2023 përmes e-mailit AK për marrjen e vendimit ka kërkuar afate shtese prej 3 ditëve.

Vendimi i AK për rishqyrtimin e kërkesës është bere me datën 26.10.2023 – ora 15:50

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 750,000.00 Euro **Ne rast te ofertimit si Grup i OE-ve ,nga lideri i grupit kërkohet qe ta përbush se paku 61 te vlerës se kërkuar.**	**Dëshmia. 1 Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**
Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1 - Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme me natyrën e aktivitetit (mirëmbajte ose rehabilitim i rrugëve) , në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej jomë pak se 550,000.00 Euro **Ne rast te ofertimit si Grup i OE-ve ,nga**	**Dëshmia 1 - Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar** Aneksin 6 **te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar: titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.**

lideri i grupit kërkohet qe ta përbush së min.61% shumës së kërkuar .	
Kërkesa 2 . OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon : **- Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore ,me më se paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit . Inxhinieri ne fjale të ketë dëshmi se ka menaxhuar se paku një (1) projekt te natyrës se ngjashme (mirëmbajtje, rehabilitimit te rrugëve).**	**Dëshmia 2-CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt .Vendime ose Referenca apo çfarëdo dokumenti me te cilën dëshmohet qartë përvoja specifike e kërkuar e punës për secilën pike .Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësit të jetë vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët dhe vertetuar nga noteri .**
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i makinerisë ose master i diplomuar(udhëheqës i punishtes) – drejtimi komunikacionit, me me se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit ose Barchelor i diplomuar i komunikacionit me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Inxhinieri ne fjale të ketë dëshmi se udhëhequr se paku një (1) projekt te natyrës se ngjashme (mirëmbajtje, rehabilitimit te rrugëve).	
(Dy) Teknik të Ndërtimtarisë me me se paku 5 vite përvojë punë pas diplomimit.	
Kërkesa 3 - Operatori ekonomik duhet të ketë stafë teknik në të cilët mund të thirret për realizimin e këtij projektit dhe atë minimum dhjetë (10) punëtorë teknik – ndihmës .	**Dëshmia 3 Lista e punëtorëve teknik -ndihmës me te dhënat e tyre e nënshkruar dhe vulosur, ku listës duhet ti bashkëngjiten Kontratat e punës ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt .**
Kërkesa 4 **Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit**	**Dëshmia 4** **Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat**

sipas Aneksi 7	**regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj).** **Vëmendje!** **Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.** **Vërejtje** **Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **TALI SH.P.K.**

Pergjigjje lidhur me pretendimin ankimor-Kamion special për pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhja e kripës mbi 10 ton. Lidhur me këtë pretendim ankimor sa i përket kamionit me tonazh mbi 10 tone Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor sepse AK nuk ka përcaktuar as një specifik lidhur me automjetin qe diskriminon apo favorizon ndonjë OE, po ashtu kriteri lidhur me këtë makineri është ne harmoni me nenin 7 dhe 28 te LPP-se, po ashtu kërkesa e AK lidhur me specifikimin e makinerisë është e drejt e AK te përcaktoj ne baze te nevojave te AK lidhur me aktivitetin e prokurimit duke pasur parasysh qe kërkesat te jene ne proporcion me lenden dhe aktivitetin e prokurimit.

Pergjigjje lidhur me pretendimin ankimor – Traktor mbi 2 tone për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe traktor për pastrimin e trotuareve dhe hedhjen e kripës max 2 tone. Lidhur me këtë pretendim ankimor sa i përket traktor mbi 2 tone për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe traktor për pastrimin e trotuareve dhe hedhjen e kripës max 2 tone Eksperti shqyrtues sqaron se kjo krekës duhet te sqarohet se cila është diferenca dhe qëllimi i ndryshimit te tonazhes te këtyre makinerive kur kemi te bëjmë me makineri qe përdorën për te njëjtin qellim si qeshte aktiviteti i prokurimit Mirëmbajtja e rrugëve dimëroren ne Gjilan. Ne rast se vendose te mbaj te njëjtën kerkese ne dosje te tenderit ta ngarkoj ne platform edhe sqarimin e detajuar se pse nevojitet kjo pajisje me tonazh te ndryshëm.

Pergjigjje lidhur me pretendimin ankimor – Kamion special me pajisje mulqer për kositjen e brezit te rrugëve. Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket kamion special me pajisje mulqer për kositjen e brezit te rrugëve Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, ka parapare ne paramase dhe parallogari pozicion per kositijen e brezit te rrugëve, prandaj nuk qendorn pretendimi i OE ankues per faktin se e njejta i sherben puneve te cilat jane te pershkruara ne paramasen dhe parallogarin perkatesisht pozicioni I te kategoris C ne paramases.

Pergjigjje lidhur me pretendimin ankimor – Kamion për tërheqjen e ujrave fekale/zhbllokimin e kanalizimeve me peshe bartëse 9,000kg. Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se kjo kërkesë është e pa nevojshme sepse nuk është ne proporcion me lenden e aktivitetit te prokurimit duke u bazuar ne atë se e njëjta është kompetencë e KRU Hidromorava sh.a dhe se AK nuk është kompetent për kryerjen e këtij shërbimi dhe kjo kërkesë duhet te largohet nga DT.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, te behen permisime sipas sqarimeve te dhena me sipër dhe të veprohet konform nenit 53.7 te LPP-së

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **TALI SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Shaban Tafa